



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Tetor 25, 2023

I nderuari, Z. Balijs, Kryeshef Ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës

I nderuari, Z. Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave

I nderuari, Z. Bakal, Kryetar i Bordit të Drejtorëve i Shoqatës së Bankave të Kosovës

E nderuara, Znj. Hoxha, Zyrtare e Lartë për Investime në Finance in Motion (EFSE)

Të nderuar Anëtarë të Shoqatave të Bankave

Të nderuar Anëtarë të Bordeve

Të nderuar panelistë dhe te pranishëm

Kam kënaqësinë që t'ju përshëndes dhe mirëpres të gjithëve në Konferencën “Siguria kibernetike në industrinë bankare”, e bashkë-organizuar nga Shoqata e Bankave të Republikës së Kosovës dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.

Vet fakti se kemi bashkë-organizimin, tregon për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm midis sektorëve bankare të dy shteteve tona, por edhe qasjen ndaj sfidës së përbashkët, që nuk njih kufij. Ndaj, edhe pjesëmarrja ime sot këtu, ka për qëllim që të përçojë mesazhin e tillë të bashkërendimit, koordinimit dhe përpjekjeve të përbashkëta për adresimin e këtyre rreziqeve, si sfida ndër më komplekse të kohës për industrinë financiare e më gjerë.

Jemi dëshmitar të kohës se sistemi financiar po ndryshon mjaftë shpejtë dhe po transformohet. Digjitalizimi në njërin anë ka ndikuar në përmirësimin e qasjes në shërbime si dhe në cilësinë e tyre, gjë që në fushën e pagesave, shërbimet janë duke u realizuar pandërprerë dhe të disponueshme botërisht.

Por, në anën tjetër, edhe rreziqet kryesore që lidhen me paraqitjen e teknologjisë së informacionit që mundëson shërbimet bankare dhe financiare kanë shënuar rritje dhe përbejnë një kërcënim për t'u trajtuar me kujdes. Ato përfshijnë rrezikun strategjik e reputacional, rrezikun operacional, rrezikun kibernetik dhe rrezikun e pajtueshmërisë.

Kërcënimet kibernetik vazhdon të evoluojë dhe të bëhet më kompleks në mesin e dixhitalizimit të vazhdueshëm, rritjes së varësive nga palët e treta dhe tensionet gjeopolitike.

Ritmi i shpejtë i avancimit teknologjik imponon nevojën për monitorim të vazhdueshëm të tendencave në zhvillim dhe ndikimet e tyre të mundshme në operacionet e institucioneve financiare.

Prandaj, forcimi i sigurisë kibernetike në sektorin financiar është një prioritet për stabilitetin financiar, dhe jo vetëm. Ndikimi i tij shkon deri te siguria kombëtare.

Republika e Kosovës përmes Strategjisë Kombëtare të Sigurisë ka përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e institucioneve për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturën kritike, që nga koordinimi i nismave ligjore dhe strategjike deri te zhvillimi i kapaciteteve dhe funksioneve mbrojtëse të tyre.

Në këtë kuptim, duke qenë se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës sipas mandatit ruan shëndetin e sistemit bankar dhe atë financiar në përgjithësi, i njeh dhe adreson me kujdes të shtuar aspektet e sigurisë kibernetike dhe rreziqet që vijnë nga to.

BQK-ja njeh rëndësinë kritike të sistemeve të informacionit dhe sigurisë kibernetike në sektorin financiar dhe si një masë proaktive për të ruajtur stabilitetin dhe integritetin e institucioneve financiare.

Ne jemi të përkushtuar që të avancojmë kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse për institucionet financiare në harmoni me Rregulloret dhe Direktivat e Bashkimit Evropian si dhe standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, lidhur me këtë fushë.

Sa i përket kapaciteteve dhe organizimit të brendshëm, me organogramin e ri do të krijojmë një strukturë të dedikuar për mbikëqyrjen e sistemeve të informacionit apo rrezikut kibernetik.

Do të investohet në ngritje kapacitete infrastrukturore dhe burimeve njerëzore për të siguruar që sistemet, pajisjet, njohuritë, aftësitë dhe mjetet e personelit të mbeten relevante dhe efektive në mbikëqyrjen e rreziqeve të teknologjive të reja dhe modeleve inovative të biznesit.

Objektivat kryesorë si rritja e qëndrueshmërisë kibernetike, zbutja e rreziqeve operationale, vendosja dhe zbatimi i standardeve të sigurisë kibernetike, realizimi i vlerësimeve gjithëpërfshirëse të riskut, sigurimi i reagimit efektiv ndaj incidenteve, etj., do të adresohen përmes instrumenteve dhe mekanizmave rregullator, si standardet e sigurisë kibernetike, kërkesat e pajtueshmërisë, përafrimin me standardet ndërkombëtare, plani i reagimit ndaj incidentit dhe të tjera.

Forcimi i kapaciteteve të brendshme, do të bëhet bazuar në mbështetje përmes asistencës teknike nga ekipi i specializuar i FMN-së, te cilët do të ndihmojnë në hartimin e kornizës strategjike, politikave dhe procedurave sipas standardeve më të mira botërore.

Parimet e tyre, do të jenë gjithashtu të aplikueshme për të gjithë sektorin, përmes një partneriteti konstruktiv dhe rregullues e këshillëdhënës ndaj institucioneve financiare.

Në këtë kuptim, ne si BQK presim nga industria bankare që:

- Të kenë struktura efektive të qeverisjes dhe procese të menaxhimit të rrezikut;
- Të adresojnë rrezikun kibernetik përmes strategjive, politikave dhe procedurave specifike ku përfshihen kërkesat që lidhen me qeverisjen dhe mbikëqyrjen, pronësinë dhe llogaridhënien e rrezikut, sigurinë e informacionit, etj.;

- Të kenë praktika dhe procese adekuate të menaxhimit të rrezikut kur kanë të bëjnë me shërbimet e kontraktuara nga jashtë (ang. outsourcing), të cilat përfshijnë kujdesin e duhur, menaxhimin e rrezikut operacional, monitorimin e vazhdueshëm dhe ekzekutimin e duhur të kontratave me ofruesit e shërbimeve të kontraktuara nga palët e jashtme që përcaktojnë përgjegjësitë e secilës palë;
- Të investojnë në infrastrukturë dhe kenë personel të mjaftueshëm të kualifikuar për të monitoruar dhe mbikëqyrur aktivitetet e tyre të kontraktuara nga palët e treta; dhe
- Të kenë parasysh faktorët që të sigurojnë vazhdimësinë e biznesit, konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit kur kontraktojnë shërbime nga palët e jashtme, si dhe të shtojnë vëmendjen për pronësinë e jashtme dhe prejardhjet e fondeve të klientëve, përmes mekanizmave të vëzhgimit (Investor's Screening Mechanism), pasur parasysh rreziqet aktuale gjeostrategjike.

Në fund, të përkujtojmë se adresimi i rreziqeve kibernetike kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet autoriteteve të ndryshme, me theks të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për sigurinë kibernetike në nivel shtetëror.

BQK-ja mbetet e përkushtuar për t'u koordinuar dhe ndarë informacionet me rregullatorët e tjerë, autoritetet publike përkatëse sikurse janë ato për mbrojtjen e të dhënave, për mbrojtjen e konsumatorëve, konkurrencën dhe institucionet e sigurisë kombëtare.

Njëkohësisht edhe në aspektin ndërkombëtar, me institucionet ndërkombëtare, rregullatorët e vendeve të rajonit, institucionet tjera, me qëllim të koordinimit dhe një platforme sa më të qëndrueshme për t'i bërë ballë me sukses këtyre rreziqeve dhe arritur objektivat tona.

Ju dëshiroj diskutime të frytshme në panelet në vijim, si dhe mirëpresim rekomandimet e dala nga këto diskutime profesionale.

Faleminderit!